Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Remzi Llumnica	**16.08.2023**	**13.09.2023**	**2023/0572**
Eksperti Teknik **Donijeta Sogojeva**	Data e autorizimit të ekspertit teknik **21.08.2023**		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **11.08.2023, OE "N.SH.T. VIKTORY COM"- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0572**, kundër njoftimit për kontratë, **kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku nuk është rekomanduar për kontratë OE "N.SH.T. VIKTORY COM"- Prishtinë**, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Ndertimi i Rruges X**" me nr. të prokurimit: "**632-23-397-5-1-1**", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KOMUNA E GJAKOVËS.**Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: **punë,** furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **4,357.000 €.**Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0572 i dt:11.08.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

- AK ka shkelur nenin 1 të Qëllimi LPP-së Nr. 04/L-042
- AK ka shkelur nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti të LPP-së Nr. 04/L-042
- AK ka shkelur nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të LPP-së Nr. 04/L-042

- AK ka shkelur nenin Neni 28 Specifikimet teknike
- AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së Nr. 04/L-042
- AK ka shkelur nenin 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëvetë LPP-së Nr. 04/L-042
- AK ka shkelur nenin 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës të LPP-së Nr. 04/L-042
- AK ka shkelur nenin 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale të LPP-së Nr. 04/L-042
- AK ka shkelur nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë të LPP-së Nr. 04/L-042
- AK ka shkelur nenin 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve të LPP-së Nr. 04/L-042

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Vendimi i Autoriteti Kontraktues eshtë skandaloz dhe diskriminues ndaj kompanisë tone ku shkelen parimet kryesore siç eshtë ekonomiciteti dhe efikasiteti, barazia ne trajtim – jo diskriminim, shkelet kodi etik i prokurimit publik dhe vet etika profesionale.

Ju si AK , me datën 24.07.2023, keni publikuar njoftimin mbi rezultatin e aktivitetit te prokurimit te larte përshkruar, ku kompaninë tone sipas letrës standarde te te njëjtës date e keni eliminuar grupin e OE-ve tone, me arsyetimin se:

1. " Ju si grup i OE-ve, Lista e Kontratave te realizurara jo sipas formes se listes ne Aneksin 7 te FDT-se ki shkruan : Ky Ankes eshte obligativ qe te plotesohet dhe te bashkengjiten certifikatat perkates ose ndonje dokument tjeter qe evidenton performimin e tille, pra ky ankes nuk eshte plotesuar dhe dorzuar.
2. Mungon Lista e pajisjeve sipas aneks 7 te fdt-se ku shkaruan ky Aneks eshte obligativ qe te plotesohet dhe ti bashengjiten certifiakata perkatese ose ndonje dokument tjeter qe evidenton perfomimin e tille.
3.
4. Mungon Lista e Satfit profesional – Menaxherve te projektit ing Izabela Muca dhe ing Beq Hadergjonaj ju mungon certifikata per siguri dhe shendet si dhe certifikata per menaxhimin e projektve
5. Udheheqesi i punishtes z Besnik Zogu i mungon Certifikata per menaxhim dhe organizim te kantieri
6. Inxhinerit te Elektrikes z.Krist Duzhmani i mungon CV dhe Kontrata e punes.

Per mungesa te dokumenteve tek stafi profesional qe jane cekur me larte , nuk eshte kerkuar sqarime shtese konform nenit 72 te LPP-se per shkak te se mungojn lisat e lart cekura te cilat jane fakte eliminuese.

Pretendimet ankimore nga OE "N.SH.T. VIKTORY COM"- Prishtinë drejtuar OSHP- se lidhur me arsyet e eliminimit dhe vendimi mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim nga AK-ja.

Pretendimi ankimore 1.

Arsyetimi eliminimit lidhur me atë se ne si kompani nuk kemi plotesuar Ankesin e Kontratave eshte i pa bazuar pasi qe ne kemi plotesuar dhe bashkangjitur listen e Projekteve sipas Aneksit te Dosjes se Tenderit eshte cekur Aktiviteti i Prokurimit si dhe Nr i prokurimit. Gjithashtu sipas Aneksit qe eshte ne dosjen e tenderti mund te paraqesim nje dokument tjeter qe

evidenton perforormimin e tillë para ne jemi konform kritereve te kontrates dhe e plotesojm Aneksin e Kontratave siq eshte para pare ne DT gjithashtu do ju bashkangjesim si deshmi edhe njehere Listen e Projekteve.

Vretje qfar do liste qe bashkangjesim ne lidhje me listen e projektve eshte e pranushme sipas LPP dhe UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK pra ju si AK jeni duke tentuar qe te beni diskriminim dhe mashtrim.

"Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direket me lëndën e kontratës

-PROVE – Lista e Projektev Ankesi i Kontratave

Pretendimi ankimore 2.

Arsyetimi, tjetër i eliminimit lidhur me listen e pasijeve si pas Ankesit te DT edhe ky pretendim eshte i pa bazuar sepse ne kemi paraqitur Listen e Pasijeve sipas DT mbas ndyshimeve qe i keni bere ju si AK ne kushtet dhe kriteret e DT.

Ju si AK jeni ne kundershtim me kerkesat tuaj te DT andaj krejt keto pretendime nga ju jane te pa bazuara.

"Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direket me lëndën e kontratës

-PROVE – Lista e Paisjeve

Pretendimi ankimore 3.

Lidhur me arsyetimin tjetër se ing ju mungon certifikatat per siguri dhe shendet ne pune eshte e pa bazuar pasi qe ne kemi paraqitur ing Zijadin Mehmeti i cili ka certifikaten Siguria dhe Shendeti ne Pune, do te ju bashkangjesim deshmit. Ne si GOE i plotesojm te gjitha kerkesat e parapara ne dosjen e tenderit dhe jemi te pergjegjshem sipas Kritereve te DT andaj pretendimet nga AK jane te pa bazuara dhe nuk jane konform te DT pra vlersimi nuk eshte bere sipas Kritereve te FDT-se me posht mund te gjeni deshmin e sipas DT.

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 50 (pesdhjetë) punëtorë si dhe staf të mjaftueshëm profesional për kryerjen e projektit si ne vijim a).Një inxh. Ndërtimtarisë i inxhinierisë së Ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv apo infrastrukturës rrugore),ose Master i inxhinierisë së Ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv apo infrastrukturës rrugore), menaxher i projektit me 5 vite përvojë pune pas diplomimit për menaxhim te projekteve. b).Një inxh. i dipl. i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, ose Master drejtimi konstruktiv udhëheqë i punishtes me 5 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës ne punishte ne projektet e ndërtimit, rehabilitimit apo ri-konstrukturimit te rrugëve, te jetë i certifikuar për menaxhim dhe organizim te kantierit. c).Një inxh. i dipl. i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv ose Master drejtimi konstruktiv me 5 vite përvojë pune pas diplomimit dhe dëshmi se ka realizuar së paku 2 projekte te natyrës se njejtë. Të jetë i certifikuar për mbrojtje dhe siguri ne pune. Ç).Një inxh. i dipl. i gjeodezisë i licencuar me 3 vite përvojë pune pas diplomimit dhe dëshmi qe ka realizuar minimumin 2 projekte ne lëmin e kërkuar. d).Një inxh. i dipl. i Ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknikë me 3 vite provojë pune pas diplomimit. Dh).Një inxh. i dipl. i Elektroteknikës ose Master me 3 vite përvoje pune.

f).Një inxh. i dipl. i Komunikacionit me 3 vite përvojë pune pas diplomimit ose bachelor i diplomuar i komunikacionit me 5 vite provoj pune pas diplomimit.

"Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direket me lëndën e kontratës

PROVE – Lista e Ing dhe deshmit tjera.

Sipas Ligjit te Prokurimit Publik dhe UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK konkretisht sipas Nenit 38 Sqarimi i Tendereve eshte dashur te kerkohet sqarime shtes per te plotesuar ose sqaruar dokumentet e paraqitura pra AK nuk e ka marr per baze Ligjin e Prokurimit Publik dhe ka propuzuar nje GOE te pa pergjegjshem me posht gjeni sqarimin si pas Udhezuesit Nr.001/2023 per Prokurim Publik.

Neni 38 Sqarimi i Tenderëve

38.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK "Kërkesë për sqarim të tenderit". Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformës elektronike.

38.2 Asnjë ndryshim në çmim ose kusht tjetër material ose aspekt të tenderit nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet.

38.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate.

38.4 Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, çertifkatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura.

38.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë çertifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, çertifkatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE.

Autoriteti Kontraktues ka Propuzuar per Kontrate GOE Pe Vla-Ku & Joos Krasniqi -Baze dhe Roza Komani B.I te papergjegjsh ku nuk i kan plotesuar Kushtet dhe Kriteret per Kontrate.

Me posht do te gjeni deshmit dhe provat qe gjenden ne Oferten e GOE ne fjale.

Deshmia 1 Lista e pasijeve e cila eshte paraqitur ne Oferten e Dorzuar nuk i permbush kushtet dhe eshte ne kundershtim me kriteret e kontrates pra tek Paisja (Luge Riper Hidraulike) Ky GOE ka paraqitur ngarkues gje qe eshte ne kundershtim me LPP dhe me Kriteret e Dosjes se Tenderit tek ky kritet AK eshte dashru te Refuzoj Tenderin eshte kusht Administrativ.

Gjithashtu AK ka bere shkelje duke i kerkuar sqarime ne kete pike gje qe nuk eshte dashur te kerkohet sqarim ne kete pike por duhet te eliminohet automatikisht pasi qe nuk eshte i pergjegjshem.

Deshmia 2. GOE ka paraqitur Dokumente te cilave nuk ju pershtatet pesha me specifikacione te makineris gje qe keni deshmu edhe ju ku OE Lika Trade ka tenjeta pasije me numer dhe me te gjitha specifikat tek pasisja Finisher me pesh min 25t, kurse GOE ka te njejtin dhe keni shpallur te pergjegjshem, gjithashtu ne kemi bere hulomtim dhe kemi pare qe keto pasije kan pesh deri 20ton jo siq ka pretenduar GOE se ka peshe mbi 25t. Ju si AK duhet te i vertetoni keto dokumente siq e keni cekur edhe ne Dosjen e Tenderit me posht mund te gjeni deshmin.

Për pikat me sipër Autoriteti Kontraktues mund të bëjë verifikimin e çdo dokumenti si dhe inspektimin e kapaciteteve teknike e profesionale të gjithë Operatorëve Ekonomikë tenderues për qëllime të verifikimit. Nëse Operatori Ekonomik ka paraqitur të dhëna të rrejshme automatikisht do të eliminohet nga vlerësimi dhe oferta e tij do të konsiderohet si ofertë e papërgjegjshme.

Deshmia 3. GOE i mungon thuajse e gjithe makineria ka dokumente qe ka paraqitur ne kete dosje tenderit te cilat nuk jane ne perputhje me kriteret e DT siq jane :

GOE ju Mungon Buldozheri, bulduzheri i paraqitur nuk e permban peshen mbi 25t pas hulomtimeve qe kemi bere, gjithashtu nuk ka deshmi per buldozherin e huazuar nga Kompania Gjoka Konstruksion sh.p.k. ,

Bludozheri TG220B ka peshen 22.ton sipas specifikave te makineris dhe hulomtimit nga ne.

Mungon ngarkusi me pesh mbi 32t

Kan paraqitur nje marrveshje me kompanin BIBA-X per ngarkues tipi Liehber L564 i cili nuk e ka ate pesh por sipas specifikimeve te makineris ka pesh 22t.

Te gjitha keto dokumente jane te dyshimta dhe kan hapsire per hetime

Deshmia 4. Ne dosjen e tenderit ka shume Dokumente te OE PE-VLA-KU shpk me seli ne Shqiperi ku jane paraqitur disa marrveshje tjera ku Vet kompania nuk eshte pjes e Koncerzumit nuk ka dorzuar Deklarat nen Betim pra e i gjith grupi eshte Administrativsht i pa pergjegjshem.

OE te tjera te cilet jane pjesemarres ne kete Aktivitet te Prokurimit jane te pa pergjegjshem siq keni potensuar ju.

Per GOE Asfalt Group shpk, Gurëbardhi shpk,Benita Company, Dreoni shpk. Siq ka potensuar AK dhe e ka pranuar edhe vet Grupi per kete gabim qe gjendet ne Oferten e tyre pra Lideri I Grupit ka prezantuar liste te kontratave ne vlere prej 1,808,522.58€ kurse ne dosjen e tenderit eshte kerkuar qe lideri te kete 3,921,000.00€ nese lista nuk I permbush kushtet duhet te refuzohet automatikisht nuk mund te kerkohet sqarime shtes per nje list ku vete OE e ka prezantuar sipas UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK thot keshtu:

Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

Autoriteti Kontraktues ka vepruam me te drejt ndaj ketij GOE Asfalt Group shpk, Gurëbardhi shpk,Benita Company, Dreoni shpk pasi qe lista e dozuar nuk përmbush **kerkesat minimale te vleres se perckatuar duhet te refuzohet tenderi.**

Autoriteti Kontraktues duhet ti permahet ligjit te prokurimit publik, jemi GOE me cmimim me te ulet ne kete Aktivitet dhe jemi te pergjegjshem AK duhet ti trajtoj OE ne menyre te barabart ashtu siq e percakton

neni 7 i LPP-se.

Neni 1 Qëllimi 1.

1 Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe burimeve publike në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla

Neni 6, i LPP-se përcakton:

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet

publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Neni 7, i LPP-se, përcakton:

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

Kerkojm nga AK Komuna e Gjakoves qe te merret per baze kjo ankes e jona, lenda te kthet Ri-vlersim, pasi qe Grupi i OE i cilsuar i suksesshem nga ju nuk i ploteson Kushtet as Kriteret minimale per kontrate dhe Admininstrative.

– Ne si Grup i OE N.SH.T VIKTORY COM Pjeter Qerimi B.I & COMPANY Eskavatori SH.P.K& Marisa sh.p.k i poltesojm te gjitha kushtet dhe Kriteret per Kontratë.

Dëmet materiale

Te konsiderueshme, dame te cilat do te kalkulohen pas përfundimit te procesit.

Përgjigje dhe dokumentacioni percjellës sa i përket kërkeses për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit nga OE "N.SH.T. VIKTORY COM"- Prishtinë - Vendimi mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim nga AK-ja.

1.Vendimi i AK mbi refuzimin e kerkeses per rishqyrtim nga AK i dates 03.08.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.07.2023, të parashtruar nga Grupi i Operatorëve ekonomik **NSHT "VIKTORY COM"; Company Eskavatori shpk; Marisa SH.P.K;** lidhur me aktivitetin e prokurimit me "**Ndërtimi i Rrugës X"**, Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 - 511, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Grupi i Operatorëve ekonomik **NSHT "VIKTORY COM"; Company Eskavatori shpk; Marisa SH.P.K;** lidhur me aktivitetin e prokurimit me "**Ndërtimi i Rrugës X"**, Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003-511, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 24.07.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, **i publikuar me datë: 24.07.2023;**

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.27.07.2023, Grupi Operatorëve ekonomik **NSHT "VIKTORY COM"; Company Eskavatori shpk; Marisa SH.P.K;**, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "**Ndërtimi i Rrugës X"**, Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.08.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1

Pretendimi juaj ankimor në lidhje me eliminimin e ofertës tuaj janë të pabazuar, sepse nga ju nuk është plotësuar dhe dorëzuar Aneksi 7 i DT-ës, në të cilin shkruan: Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë. Ju nuk keni dorëzuar Aneksin 7 ashtu siç është kërkuar në DT.

Në lidhje me pretendimet tuaja ndaj GOE të rekomanduar për kontratë, ju njoftojmë se janë të pa qëndrueshme për shkak se GOE i rekomanduar për kontratë ka sejllë sqarime shtesë të cilat kanë qenë bindëse që oferta e tyre të jetë e përgjegjëshme.

Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesëankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës

2. Kerkese drejtuar OE i rekomanduar per kontrate - Leter standarde e kerkeses per informata mbi tenderet nga AK i dates 18.07.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët

Gjakovë: 18.07.2023

KOMUNA E GJAKOVËS, Rr "Nënë Tereza" 50000 GJAKOVË

Për: Grup i Operatorëve Ekonomik PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; Roza Komani B.I. Rr. Tringe Smajli 16/7. 10000, Prishtine

Nr. i prokurimit:	**632-23-397-5-1-1**
Nr i brendshëm	**632-23-003-5-1-1**

Titulli: Ndërtimi i Rrugës X

I/e nderuar(a) [Z/Znj]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP"

Pas vlerësimit dhe analizimit te dokumenteve qe ju keni dorëzuar kemi vërejtur këto mangësi:

Sqarim:

Ju si Grup i Operative Ekonomik keni prezantuar dokumentet si ne vijim:

- Udhëheqësi i punishtes, ing. Redi Binaj, ka kontratë me afat të caktuar me PE-VLA-KU-n, e cila i skadon 23.03.2024, projekti për të cilën kanë ofertuar ka kohëzgjatje 3 vjet, pra kontrata me inxhinierin është e përkohshme me afat të caktuar – kërkohen sqarime ose plotësim te këtij dokumenti sipas kërkesës se FDT-es.

- Ing. Agron Doli, nuk është gjetur certifikata për mbrojtje dhe siguri në punë - – kërkohen sqarime ose plotësim te këtij dokumenti sipas kërkesës se FDT-es.

- **Tek Lista e Pajisjeve:**

- Në pikën 3 tek kërkesa për kamion dumper mbi 30 ton, janë prezantuar koka tërheqëse dhe gjysmë-rimorkio - kërkohen sqarime teknike nëse këta kamion mund të kryejnë funksionin e kamionit dumper
- Për pikën 8 – Ngarkues mbi 32t, nuk është gjetur dëshmia për këtë pajisje - kërkohen sqarime ose plotësim te këtij dokumenti sipas kërkesës se FDT-es.

- Për pikën 12 – Janë prezantuar dy ngarkues me lopat, ndërsa është kërkuar Ripper me peshë min 2.5t dhe maksimum 3t. - kërkohen sqarime teknike nëse këta ngarkues mund të kryejnë funksionin e Ripperit me peshe min. 2.5t dhe maksimum 3t.
- Në pikën 18 dhe 19 janë prezantuar finisher pesha e të cilave nuk duket në DUD ose nuk është dëshmuar fare. - kërkohen sqarime ose plotësim te këtij dokumenti sipas kërkesës se FDT-es.
- Për pikën 23 Kamion spërkatës për bitumin dhe emulsion – nuk është gjetur dëshmia për këtë pajisje - kërkohen sqarime ose plotësim te këtij dokumenti sipas kërkesës se FDT-es.

Duke u bazuar ne neni 72 të LPP-së, për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj te cekura me lartë.

Përgjigjja ose përgjigjet e juaja sqaruese duhet të pranohen përmes platformës se e- prokurimit elektronik deri **me dt. 24.07.2023 në ora 16:00**
Pa përgjigjën nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda afatit kohor të lartë shënuar, tenderi i juaj do të refuzohet.
Ju falënderojmë paraprakisht,
Me respekt,

Faton Gutaj

[Nënshkrimi]

3.B58- Njoftim mbi vendimin e AK i dates 24.07.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]
Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Ndërtimi i rrugës X

Nr. i prokurimit	**632-23-397-5-1-1**
Nr i brendshëm	**632-23-003-511**

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave[2]
1.	" Shkembi " Sh.p.k., Zona Industriale, -31000, ISTOG	4,514,770.28€
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik ASFALT GROUP SH.P.K.; GURËBARDHI SH.P.K.; Benita Company; DREONI SH.P.K., Gremnik, Klinë, 32000, Gremnik	4,333,333.33€
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; Roza Komani B.I., Rr. Tringe Smajli 16/7, 10000, Prishtine	4,270,543.21€
4.	ARFA GROUP SH.P.K., Rr. Dautaj - Sllup, 23, Deqan	4,442,572.61€
5.	„Lika Trade" Sh.p.k., Isniq-Deçan, 51000, Deçan	4,171,825.00€
6.	Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori Sh.p.k.; Marisa SH.P.K., Rr. Tirana, 50000, Gjakovë	4,070,546.33€

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
Komuna e Gjakove **shpërblen** me kontratë: **Grup i Operatorëve Ekonomik PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; Roza Komani B.I.**, në vlerë totale të ofertës **4,270,543.21€.**

Data: 24.07.2023
Emri dhe mbiemri i ZPP: Faton Gutaj

[1] Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde te njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojes).
[2] Në rast të procedurave të kufizuara/procedurave konkurruese me negociata t'i bashkangjiten letrat standarde të njoftimeve: B43 dhe B44.(shto letra standarde sipas nevojës), derisa kolona "Vlera totale e ofertave" nuk plotsohet me te dhena.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

4.B42 - Leter standarde per tenderuesin e eliminuar nga AK i dates 24.07.2023

B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar [6]

Gjakovë 24/07/2023

Komuna e Gjakovës, Rruga UÇK (ndërtesa e ish Bankosit) Zyra e Prokurimit
kati I-rë Gjakovë

Për: Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori Sh.p.k.; Marisa SH.P.K., Rr. Tirana, 50000, Gjakovë

Nr. i prokurimit	632-23-397-5-1-1
Nr i brendshëm	632-23-003-511

Titulli: Ndërtimi i rrugës X

I nderuar Z.

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim: Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM
Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :
- Ju si Grup i Operatoreve Ekonomik keni prezantuar :
Lista e kontratave të realizuara jo sipas formës së listës në Anksin 7 të FDT-ës, ku shkruan: Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë, pra ky aneks nuk është plotësuar dhe dorëzuar.
Mungon lista e pajisjeve sipas aneks 7 të FDT-ës ku shkruan Ky Aneks është obligativ qe te plotësohet dhe ti bashkëngjiten certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë
Mungon lista e stafit profesional
- Menaxherëve të projektit ing. Izabela Muca dhe ing. Beq Hadergjonaj, ju mungon certifikata për siguri dhe shëndet si dhe certifikata për menaxhimin e projekteve
- Udhëheqësi i punishtes z. Besnik Zogu, i mungon certifikata për menaxhim dhe organizim të kantierit.
- Inxhinierit të Elektrikes z. Kristë Duzhmani i mungon CV-ja dhe Kontrata e punës.

[6] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojes).*

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Duke pasur parasysh se Grup i OE nuk i plotësoni kërkesat e sipërpërmendur të FDT-së, përkatësisht ka prezantuar liste për kontrata te realizuara dhe listë të pajisjeve te cilat nuk janë ne përputhje me listën për kontrata të realizuara dhe listën e pajisjeve sipas aneks 7 te FDT-ës, andaj kjo ofertë është refuzuar për shkak se dy listat e lartë cekura nuk janë plotësuar dhe dorëzuar ashtu siç kanë qenë të përcaktuara ne FDT (ka qenë obligimi plotësimi dhe dorëzimi i tyre me ofertë).

Për mungesa te dokumenteve tek stafi profesional qe janë cekur me lartë, nuk është kërkuar sqarime shtesë konform nenit 72 të LPP-ës për shkak se mungojnë listat e lartcekura te cilat janë fakt eliminues për ofertën tuaj.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Faton Gutaj *(Nënshkrimi)*

5.B45 - Leter standarde per tenderuesin e suksesesheim nga AK i dates 24.07.2023

B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm[8]

Gjakovë 24/07/2023

Komuna e Gjakovës, Rruga UÇK (ndërtesa e ish Bankosit) Zyra e Prokurimit kati I-rë Gjakovë

Për: **Grup i Operatorëve Ekonomik PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; Roza Komani B.I. Rr. Tringe Smajli 16/7, 10000, Prishtine**

Nr. i prokurimit	**632-23-397-5-1-1**
Nr i brendshëm	**632-23-003-511**

Titulli: Ndërtimi i rrugës X

I nderuar Z.

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar tenderin ekonomikisht më të favorshëm si përgjigje ndaj njoftimit të kontratës për aktivitetin e prokurimit te lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj në vlerë prej **4,270,543.21€** në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit te intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.

Bashkëngjitur me këtë letër është kontrata.

Bashkangjitur: Kontrata

Me respekt,

Faton Gutaj *[Nënshkrimi]*

[8] *Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata*

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

6.B42 - Vendim mbi aprovimin e kerkeses per rishqyrtim nga AK per OE PE-VLA-KU shpk i dates 04.05.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 04.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.04.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **"PE-VLA-KU" sh.p.k.,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës X " , Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003-511, nxjerr:**

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **"PE-VLA-KU" sh.p.k., e dt.26.04.2023**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës X " , Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003-511,** kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së të publikuar me datë 14.04.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Përmirësohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 14.04.2023;**

3.Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëj përmirësimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **"PE-VLA-KU" sh.p.k., me dt.26.04.2023**, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i rrugës X " , Nr. i prokurimit-632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003-511.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.05.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë lidhur me certifikimet e inxhinjerëve, është i bazuar dhe Autoriteti kontraktues vendos që të bëj përmirësimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë;

Pretendimi juaj i dytë lidhur me pajisjet, është i bazuar dhe Autoriteti kontraktues vendos që të bëj përmirësimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqeseënkesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

7.Vendim mbi pezullimin e aktivitetit te prokurimit deri ne nje vendim te radhes nga OSHP - nga AK i dates 10.08.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 11.08.2023

Komunës së Gjakovës duke vendosur sipas njoftimit të pranuar nga OSHP për ankesën e Operatorit Ekonomik **Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori Sh.p.k.; Marisa SH.P.K., të dt.11.08.2023,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës X", me Nr. të Prok: 632-23-397-5-1-1**, Nr. Brendshëm **632-23-003-511**, të inicuar nga Komuna e Gjakovës nxjerr:

VENDIM
MBI PEZULLIMIN E AKTIVITETIT TE PROKURIMIT DERI NE NJE VENDIM TE RADHES NGA ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Pezullohet deri ne vendimin e ardhshëm aktiviteti i prokurimit me titull: **" Ndërtimi i rrugës X", me Nr. të Prok: 632-23-397-5-1-1**, Nr. Brendshëm **632-23-003-511**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Të gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës

8.Vendim mbi pezullimin e aktivitetit te prokurimit - nga AK i dates 31.07.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë: datë,31.07.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 61 (paragrafi 61.1) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.07.2023 të parashtruar nga Grupi i Operatorëve ekonomik **N.SH.T. VIKTORY COM; Companya Eskavatori SH.P.K; Marisa SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me "**Ndërtimi i Rrugës X**", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511, nxjerr:

VENDIM
MBI PEZULLIMIN E AKTIVITETIT TE PROKURIMIT

Pezullohet aktiviteti i prokurimit me titull: "**Ndërtimi i Rrugës X**", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-397-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-003 -511.

I. Për hapat tjerë lidhur me këtë aktivitet te porkurimit,me kohë do të jeni të informuar përmes platëformes së prokurmit elektronik

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : htp://e-prokurimi.rks-gov.net/

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të	**1. Deklaratën nën betim se Operatori Ekonomik përmbush kë mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi**

Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rksgov. net 2. Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës. 3. Vërtetim nga Gjykata kompetente.	**Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga Administrata T e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimev paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të ten Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohe shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktu publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktue vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, n drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kal a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerje vepre penale; dhe b. Operatori Ekonomik nuk është ne falime ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dh Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozo shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktu publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktue Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shp me kontratë të sjellë dokumentet të kërkuara në pikën, 2 dhe të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, të kon sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj proc për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe të me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është ne vendin e dytë.**
Përshtatshmëria profesionale:	**Dështmia e kërkuar dokumentare:**
Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.	**Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje).**
Certifikata per Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK	**Certifikata për regjistrim në TVSH (kopje).**
Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	**Dështmia e kërkuar dokumentare:**
Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar me një vlerë të përgjithshme prej së paku 8,710,000.00€, në 3 (tri) vitet e fundit, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% të vlerës së qarkullimit.	**Deklaratat dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës a kopjet e raporteve finaciare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licensuar për kontrollim a auditor i licensuar i pavarur ose dokument nga banka (Raport qarkullimin banker)**
Kapaciteti teknik dhe professional:	**Dështmia e kërkuar dokumentare**
Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dështmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 6,535.000,00€, gjatë tre viteve të fundit , në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% të vlerës së qarkullimit.	**Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shu kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfitu dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për krye punëve, në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dh referenca me Operator Ekonomik privat atëherë Operatori Ek duhet të prezanton situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontratë-re**
Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dështmi se	**Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit**

ka së paku 50 (pesdhjetë) punëtorë si dhe staf të mjaftueshëm profesional për kryerjen e projektit si ne vijim a).Një inxh. Ndërtimtarisë i inxhinierisë së Ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv apo infrastrukturës rrugore),ose Master i inxhinierisë së Ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv apo infrastrukturës rrugore), menaxher i projektit me 5 vite përvojë pune pas diplomimit për menaxhim te projekteve. b).Një inxh. i dipl. i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, ose Master drejtimi konstruktiv udhëheqë i punishtes me 5 vite përvojë pune pas diplomimit si udhëheqës ne punishte ne projektet e ndërtimit, rehabilitimit apo ri-konstrukturimit te rrugëve, te jetë i certifikuar për menaxhim dhe organizim te kantierit. c).Një inxh. i dipl. i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv ose Master drejtimi konstruktiv me 5 vite përvojë pune pas diplomimit dhe dëshmi se ka realizuar së paku 2 projekte te natyrës se njejtë. Të jetë i certifikuar për mbrojtje dhe siguri ne pune. Ç).Një inxh. i dipl. i gjeodezisë i licencuar me 3 vite përvojë pune pas diplomimit dhe dëshmi qe ka realizuar minimumin 2 projekte ne lëmin e kërkuar. d).Një inxh. i dipl. i Ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknikë me 3 vite provojë pune pas diplomimit. Dh).Një inxh. i dipl. i Elektroteknikës ose Master me 3 vite përvoje pune. f).Një inxh. i dipl. i Komunikacionit me 3 vite përvojë pune pas diplomimit ose bachelor i diplomuar i komunikacionit me 5 vite provoj pune pas diplomimit.	**profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e pu në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titu projektit për të cilin ka lidhë kontratë, për projekt menaxheri të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin, si dhe numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim em mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani.**
Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT.	**Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomi marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të d edhe marrëveshjen për shfrytëzim.**
Operatori Ekonomik duhet te kete Bazë për asfalt nga një kompani e liçencuar ose marrëveshje për furnizim Gurëthyes dhe separacion të liçencuar ose marrëveshje për furnizim	**Kopjet e licencave te vlefshme te lëshuar nga Agjencioni për M dhe Minerale. Vërejtje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashka duhet te jete Licencat e Operatorit Ekonomik. Marreveshja d jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit.**
Operatori Ekonomik duhet te ketë stafin e trajnuar dhe te certifikuar për SSHP(siguri dhe shëndet ne pune (për 25 punëtorë)	**Certifikatë valide (kopje)**
Operatori Ekonomik duhet te ketë vlerësimin e rriskut për te gjitha pozitat e punës nga një	**Vërtitim nga një kompani e licencuar nga MPMS (kopje).**

kompani e licencuar MPMS dhe te dëshmohet me raport te noterizuar	
Operatori Ekonomik duhet te ketë një ekspert për SSHP siguri dhe shëndet ne punë te certifikuar nga MPMS.	**Certifikatë nga MPMS (kopje).**
Operatori Ekonomik duhet te ketë Lead Auditor sipas ISO 9001 2015- sistemi i menaxhimit te cilësisë	**Certifikatë valide (kopje)**
Operatori Ekonomik duhet te ketë ISO 14001-2015 Sistemi i Menaxhimit te mjedisit,	**Certifikatë valide (kopje)**
Operatori Ekonomik duhet te ketë një Lead auditor udhëheqës sipas kërkesës së ISO 45001-2018 Sistemi i Menaxhimit te sigurisë dhe shëndet ne pune	**Certifikatë valide (kopje)**
Operatori Ekonomik duhet te ketë një ekspert të certifikuar nga AME (agjensioni për menaxhimin e emergjencave) për mbrojtje nga zjarri.	**Certifikatë valide (kopje)**
Për pikat me sipër Autoriteti Kontraktues mund të bëjë verifikimin e çdo dokumenti si dhe inspektimin e kapaciteteve teknike e profesionale të gjithë Operatorëve Ekonomikë tenderues për qëllime të verifikimit. Nëse Operatori Ekonomik ka paraqitur të dhëna të rrejshme automatikisht do të eliminohet nga vlerësimi dhe oferta e tij do të konsiderohet si ofertë e papërgjegjshme.	
LISTA E PAISJEVE	

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

RAPORTI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

Procedura e hapur
Procedurë e hapur me Njoftim paraprak; Vlerë e madhe

Në bazë të nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data kur është përgatitur Raporti i Vlerësimit: **25.05.2023**

Nr. i prokurimit [1]	**632-23-397-5-1-1**
Nr i brendshëm	

Titulli: Ndërtimi i Rrugës X

DEKLARATË

[të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim]

Në bazë të kritereve të përcaktuara në Njoftimit për Kontratë dhe dosjes së tenderit, Komisioni për vlerësimin e Ofertave I emë
23.05.2023.I cili filloj punën me 25.05.2023, pas procesit të vlerësimit dhe krahasimit të tenderove konstatoi se kishin ofertuar 6
